



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice
Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar/Agjencia za
Administraciju Zaplenjenje ili Konfiskovane Imovine/Agency for Administration of
Sequestrated or Confiscated Assets

SHPALLJE

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar duke u bazuar dispozitat në Ligjin mbi marrëdhëniet e detyrimeve, me qëllim të zbatimit të Rregullores së brendshme për detyrat dhe përgjegjësitë e administratorit të pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar përmes Kontratës - Marrëveshjes për shërbime të veçanta kërkon angazhimin e shtate (7) administratorëve për ofrimin e shërbimeve për pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuara në kuadër Agjencisë konkretisht në Departamentin për pranim, ruajtjen e vlerës dhe shitjes së pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar. Të njëjtit për shërbimet e ofruara do të shperblehen në tarifë prej 326 € në muaj.

Kohëzgjatja e Kontratës (Marrëveshjes për shërbime të veçanta) është për pesë (5) muaj.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Administratori i pasurisë është përgjegjës për ruajtjen e pasurive të sekuestruara ose të konfiskuara që janë nën përkujdesjen e tij në bashkëpunim me gjykatën, prokurorinë ose organet tjera kompetente dhe në pajtim me ligjin në fuqi, veçanërisht në pajtim me nenin 4 të ligjit Nr. 03/L-141 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar;
- Administratori i pasurisë do të veproj në pajtim me rregullat dhe politikat e përcaktuara nga Agjencia mbi pranimin, ruajtjen dhe shitjen e pasurive dhe në përputhje me procedurat operative të Agjencisë;
- Administratori i pasurisë duhet të përgatit një plan të të hyrave dhe shpenzimeve lidhur me pronën e cila është nën administrimin e tij dhe përmes drejtorit të departamentit për pranimin, ruajtjen e vlerës dhe shitjes së pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, të cilin e dorëzon për pranim tek Kryeshefi i Agjencisë në pajtim me nenin 5 paragrafi 3 i UA Nr. 1/2010;
- Administratori i pasurisë duhet të përgatit raporte tjera sipas kërkesës së Kryeshefit të Agjencisë apo raport progresi në raste të veçanta sipas kërkesës së gjykatës, prokurorit ose autoritetit kompetent;
- Administratori i pasurisë do t'i raportoj në baza të rregullta drejtorit të departamentit për pranimin, ruajtjen e vlerës dhe shitjes së pasurisë;

- Administratori i pasurisë do të jetë përgjegjës për administrimin e pasurive të tij si nikoqir i mire dhe gjatë tërë kohës, në bashkëpunim me prokurorin dhe gjykatën, do të synoj ta ruaj vlerën e pasurisë. Në këtë drejtim AP do ta ketë parasysh koston e administrimit të pasurisë por nuk duhet të jetë i shtyrë nga profiti;
- Administratori i pasurisë mundet që, me autorizimin e Agjencisë, ta mundësoj qasjen e arsyeshme tek pasuritë që mbahen nga Agjencia për qëllime inspektimi qoftë të pronarit (në rast të pasurive të sekuestruara) ose ndonjë autoritet tjetër ose për qëllime auditimi apo sigurie;
- Administratori i pasurisë do të ketë qasje dhe do t'i mbaj regjistrat e tillë siç kërkohet nga Agjencia dhe në pajtim me klasifikimin e dokumenteve përkatëse dhe kërkesat mbi konfidencialitetin;
- Administratori i pasurisë është përgjegjës që të administroj pasurinë në mënyrë profesionale dhe me një kosto efektive;
- Administratori i pasurisë është i obliguar që ta njoftoj Agjencinë lidhur me pasuritë tjera të cilat mund të jenë objekt i masave sekuestruese, për ekzistencën e të cilave administruesi i pasurisë është informuar gjatë administrimit të sendeve.

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

- Përgatitje universitare;
- Një (1) vit përvojë punë ;
- Të jetë person me integritet të lartë personal dhe moral;
- Njohuri të mira të gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës;
- Aftësi të mira komunikimi;
- Njohuri të mira të punës me kompjuter;
- Patent shoferi kategori B e preferuar

Mënyra e aplikimit:

Marrja dhe dorëzimi i Aplikacioneve: Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar /Ministria e Drejtësisë / Departamenti i Administratës dhe Personelit/Divizioni i Burimeve Njerëzore, Rruga « Ish–Ndërtesa e Rilindjes» kati i 10 (dhjetë) – të, Zyra Nr. 1012, Prishtinë, Kosovë;

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni zyrën e Divizionit të Burimeve Njerëzore në, tel: 038 / 213 758 ose 038 - 200 18 259, 038 - 200 18 -172 prej orës 08:00 – 16:00.

Shpallja ngel e hapur shtatë (7) ditë nga dita e publikimit në web – faqen e Ministrisë së Drejtësisë dhe Tabelën e Shpalljeve, duke filluar nga data **14.05.2013** gjer më datën **20.05.2013** që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së Shpalljes.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrenë si dhe qertifikatën që nuk është nën hetime.

Kandidatët të cilën hynë në përzgjedhje të ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga personeli.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë përmes telefonit dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit intervistues.

“Shërbimi Civil i Kosovës u shërben të gjithë banorëve të Kosovës dhe mirëpret aplikimet nga femrat dhe meshkujt e të gjitha komuniteteve të Kosovës”.

Kërkesat e dërguara pas datës të mbylljes së shpalljes nuk do të pranohen si dhe ato të pakompletuara mund të refuzohen.